



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FIER

RELACION TEKNIK

OBJEKTI : “ Rikonstruksioni i argjinatures per mbrojtjen nga lumi Vjosa (bankina e krahut te majte te Deges se Martines prog: (9958-11308) ml) zona Ferras – Ura e Qarrit L= 1350 ml “ , Bashkia Fier

• TE DHENA TE PERGJITHESHME PER ARGJINATURAT MBROJTESE TE LUMIT VJOSA

Trajtimi i permbytjeve nga lumi Vjosa eshte kryer qe me projektimin dhe zbatimin e sistemit te kullimit dhe te ujitjes nga te dyja anet e tij , si nga ana e Fierit ashtu edhe nga ana e Vlores . Sistemi ujitjes me kanalin Vjose – Levan - Fier eshte nga sistemet e para ujitese te ndertuar ne zonen e Fierit . Ky kanal me gjatesi te Deges Kryesore prej 31, 295 km , se bashku me deget e tij si ajo e Martines , Pojanit , Dermenasit jane rikonstruktuar perseri sipas projektit te hartuar nga Institutit te Studimeve dhe Projektmeve te Veprave te Kullimit dhe Ujitjes te vitit 1983 . Sipas ketij projekti te rikonstruksionit kanali Vjose – Levan – Fier u llogarit per prurje 27.9 m³/sek .

Ne kohen kur lumenjte e tjere u trajtuan me argjinatura mbrojtese ndaj permbytjeve sipas standarteve te kohes per lumin Vjosa u la qe si argjinatura mbrojtese nga permbytjet te sherbenin bankinat e kanalit ujitjes Vjose - Levan – Fier dhe te Deges se Martines nga ana e Fierit dhe bankina e kanalit V-I nga ana e Vlores .

Bankina e kanalit Vjose – Levan – Fier sherben per mbrojtjen nga permbytjet ne segmentin nga Vepra e marrjes ne Selisht deri ne Varibop te Njesise Administrative Cakran , nderkohe qe bankina e Deges se Martines sherben si argjinature mbrojtese nga zona e Kashishtit te Njesise Administrative Frakull deri ne Pise – Poro te njesise administrative Levan .

Permbytja e pare nga lumi Vjosa e cila i ka kapercyer argjinaturat dhe ka permbytur siperfaqe te medha nga te dyja anet e tij ka qenene ajo e 31.12.1970 – 01.01.1971 . Mbas kesaj permbytje nuk jane vene re permbytje te tilla masive deri mbas viteve 2010 -2011 kur u ndertua autostrada Levan – Vlore dhe sidomos ura e autostrades mbi lumin Vjosa ne zonen e Ferrasit .

Ura e autostrades mbi lumin Vjosa eshte ndertuar me gjatesi 130ml aq sa eshte edhe gjeresia e shtratit te lumit ne kete vend . Ne pjesen tjeter te hapsires me gjatesi mbi 500 ml midis argjinaturave ekzistuese (Bankines se Deges se Martines nga ana e Fierit dhe Bankines se kanalit V-1 nga ana e Vlores) ku kalonte uji i lumit ne kohe plotash , tashme traseja e autostrades sherben si dige .

Ne se do ta krahasojme gjatesine e ures se hekurudhes te ndertuar ne vitin 1978 , e cila ndodhet vetem 2.9 km me siper rrjedhes , rezulton se ajo eshte gati sa dyfishi i gjatesise se ures se autostrades Levan – Vlore . Mbas ndertimit te kesaj ure parmytjet nga lumi Vjosa kane qene te shpeshta , ka pasur raste edhe dy here ne vit .

Permytja me e madhe mbas ndertimit te kesaj ure ka qene ajo e dates 01.02.2015 si pasoje e se ciles ne zonen e Fierit jane permytur rreth 7000 ha toka bujqesore dhe disa zona te banuara , nga te cilat 5300 ha kullojne me hidrovor . Uji nga kjo siperfaqe eshte larguar plotesisht me ane te 3 hidrovoeve (2 ne Darzeze dhe 1 ne Seman) vetem mbas 23 diteve .

Ne kete permytje uji ka kapercuer argjinaturen (bankinenen) e Deges se Martines nga ana e Fierit ne nje gjatesi prej afro 4877ml , nga progresivi 6 073ml deri ne progresivin 10 950 ml (nga derdhja e kolektirit te Kloses deri rreth 400 ml mbas ures se autostrades) . Ne disa segmente niveli i ujit mbi autostrade arriti 60 deri ne 70 cm .

Kjo permytje si dhe te tjerat qe pasuan ne vitet ne vazhdim e bene shume te domosdoshem studimin e permytjeve nga lumi Vjosa ne kushtet e reja te krijuara me ndertimin e autostrades Levan - Vlore , vecanerisht ures se autostrades mbi lumin Vjosa .

• DISA TE DHENA DHE KONKLUZIONE TE STUDIMIT TE VITIT 2018 : “MBROJTJA NGA PERMYTJET E LUMIT VJOSA “

Duke qene se permytjet nga lumi Vjosa u bene nje problem shume i math dhe i vazhdueshem ne territorin e bashkise Fier , sidomos per fermeret dhe banoret e njesive administrative Frakull , Levan dhe Dermenas , bashkia Fier nepermjet Drejtorise se pergjitheshme te planifikimit dhe zhvillimit te teritorit dhe Drejtorise se Projekteve te infrastruktures realizoi ne Korrik te vitit 2018 studimin : “ Mbrojtja nga permytjet e lumit Vjosa “. Ky studim , ne fazen e projekt idese , u realizua ne bashkepunim me nje grup specialiste jashtem .

Studimi u udhehoq nga Dr . inxh.. Kristo Goga . Pjesmarres ne kete projekt edhe Prof. Dr. Molnar Kolaneci , ing. Islam Zhupa , inxh. Arian Shtembari . Ne kete studim eshte perfshire e gjithë rrjedha e poshtme e lumit Vjosa (mbas Memaliajt) dhe jane trajtuar te dy brigjet . Midis te tjerave ne kete studim perfshihen :

- Hidrologjia e lumit Vjosa (rrjedha e Poshtme mbas Memaliajt) nga prof.Dr. Molnar Kokalari .
- Studimi Gjologjik nga ing. Aleksander Rukaj .
- Relacioni topografik mbi matjet topografike nga ing. Arjan Shtembari .
- Jana ndertuar kurbat e siperfaqes se lire te lumit Vjosa per $Q = 2500 \text{ m}^3/\text{sek}$ perfundimtare , $Q = 2050 \text{ m}^3/\text{sek}$, $Q = 1900 \text{ m}^3/\text{sek}$, $Q = 1700 \text{ m}^3/\text{sek}$

Ne studimi theksohet se : - Nga analiza e llogaritjeve te nivelit te ujit ne lumin Vjosa del se , qe ura e autostrades te mos preket prurja maksimale prej 2500 m³/sek kalon normalisht ne kuoten 6.47 m kundrejt kuotes se poshtme te trautes 7.55m , me nje difference prej 1.08m qe ploteson kerkesat e normave tona te projektimit .

Gjithashtu prurja prej 2500 m³/sek kalon nen uren e hekurudhes Fier – Vlore me kuote te nivelit te ujit 7.71 m nderkoh qe me projektin e ures lejohet 7.71m . Tejkalmi me 4cm nuk perbene tejkalmi te sigurise se ures dhe mund te quhet me plote te drejte se eshte konform me normave tona . Ne prurjen prej 2500 m³/sek qe kenaq keto kerkesa do ta quajm se i takon perseritjes prej 1 here ne 100 vjete qe eshte standarti per urat por qe perkon edhe me standartin per argjinaturat e klasit I .

Ketu kemi nje problem : Urat e medha dhe argjinaturat e klasit I duhet te perballojne prurjen me 1% siguri (perseritje 1 here ne 100 vjete) , por prurja 2500 m³/sek nuk i pergjigjet kesaj siguri . Ajo i pergjigjet sigurise 43.5% ose 1 here ne 2.3 vjete . Qe te jemi brenda standartit duhet qe prurja me perseritje 1 here ne 100 vjete prej 5300 m³/sek te reduktohet ne prurjen 2500 m³/sek . Ky problem mund te zgjidhet ne akset Poçem , Kalivaç , Memaliaj . –

- Gjithashtu ne kete studim jane hartuar ne fazen e projekt idese edhe profilat gjatesor te argjinatures per te dy brigjet e Vjoses si dhe profilat terdhor tip , ne perputhje me gjurmen ku kalon argjinatura .

Kuotat e kurores se argjinatures te percaktuara ne profilin gjatesor te ketij studimi jane marre si baze (reference) edhe per projektin e zbatimit per rikonstroskionin e argjinatures ekzistuese me gjatesi L=1350 ml , ne zonen nga fundi i fshatit Ferras deri tek ura mbi degen e Martines e rruges qe te con ne fshatin Ferras.

• PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I GJENDJES SE ARGJINATURES

Argjinatura per mbrojtjen nga lumi Vjosa , zona Ferrasit ura e Qarrit me gjatesi L= 1350 ml , eshte ne fakt nje segment i bankines se krahut te majte te kanalit ujites Degea e Martines me gjatesi prej 18.1 km , e cila ka sherbyer qysh me ndertimin e kanalit edhe si argjinature mbrojtese nga lumi Vjosa . Ky segment me gjatesi L= 1350 ml , nga fundi i fshatit Ferras deri tek Ura per ne fshatin Qarr i pergjigjet progresivit 9958 ml deri ne progresivin 11308 ml te kanalit ujites te Deges se Martines .

Mbas permbytjeve te vazhduesme te lumit Vjosa kryesisht mbas viteve 2011 si dhe mbas studimit te bere ne vitin 2018 , ne te cilen u percaktua kuota e nivelit te ujit per prurjen Q=2500 m³/sek si dhe kuotat e kurores se argjinaturave nga ana e Fierit dhe e Vlores , bashkise Fier qe nga Tetori i vitit 2018 filloi te merre masa per minimizimin e permbytjeve nga lumi Vjosa.

Ne bashkepunim me Ministrine e Mbrojtjes ne vitet 2018 – 2019 u be ngritja e bankines (argjinature) se kanalit ujites se Deges se Martines ne gjatesi 2510ml (nga prog. 6000 ml deri ne pro. 8510 ml) ne zonen e Çervenit . Njekohesisht me kete ne vitin 2019 u be gjithashtu ngritja e bankines se kolektorit te Kloses ne nje gjatesi prej 1100ml . Qellimi i kesaj nderhyrje ishte qe te eliminomin kalimin e ujit te plotave te lumit Vjosa ne kanalin kullues te Depresionit , nepermjet te cilit permbytet e gjithe zona prej me shume se 7000 ha qe kullon me hidrovor dhe perfshine njesite administrative Frakull , Levan , dhe Darzeze .

Ne vitin 2022 me projektin ; Rikonstruksioni i argjinatures per mbrojtjen nga lumi Vjosa zona Kafaraj – Çerven eshte bere ngritja e argjinatur (bankines se kanalit ujites Dega e Martines nga prog. 4668 ml deri ne prog. 6000 ml) per prurjen $Q = 2500 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Ne vitin 2024 me projektin ; Rikonstruksioni i argjinatures per mbrojtjen nga lumi Vjosa zona e Ferrasit $L=1448 \text{ ml}$ eshte bere ngritja e argjinatur (bankines se kanalit ujites Dega e Martines nga prog. 8510 ml deri ne prog. 9958 ml) per prurjen $Q = 2500 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Pra me nderhyrjet e bera nga viti 2018 deri ne vitin 2024 kemi rikonstruktuar ne fakte nje gjatesi totale te argjinatures mbrojtese nga lumi Vjosa me gjatesi 5290 ml (nga 18.1 km qe eshte ne total) e shtrire kjo ne zonat me te prekura , fshatrat Kafaraj – Çerven – Ferras .

Ne vazhdimesi te fshatit Ferras ne drejtim te Qarrit deri tani ne argjinature nuk jane bere nderhyrje . Ne kuadrin kur eshte bere rikonstruksioni i argjinatures ne zonen Kafaraj- Ferras (prog. 4668ml – prog. 9958 ml i bankines se kanalit ujites D. Martines) del shume i domosdoshem rikonstruksioni i argjinatures edhe ne vazhdim te fshatit Ferras deri tek Ura e Qarrit . Kjo per arsyen se tashme ne pjesen qe eshte bere rikonstruksioni uji nuk kaperderth me , dhe niveli i ujit ne Vjose rritet edhe me shume dhe kaperderth ne kete zone te pa rikonstruktuar . Kjo u vu re si ne permbytjet e 11 Dhjetorit te vitit 2021 edhe ne permbytjet e 08 Janarit te vitit 2026 ku niveli i ujit ne lumin Vjosa e kapi dyshemene e ures se vjeter te rruges Fier –Vlore dhe hidrometri shkoi ne 9.2 m .

Ne kete zone qe merr ne shqyrtim projekti (ferras – Ura e Qarrit) uji i lumit kaperderdhi argjinaturen pothuajse ne mbi 70 % te gjatesise se saj .

Argjinatura ekzistuese eshte me dhe', ka shume bimesi si ne kuroren e saj edhe ne skarpaten e jashtme . Ne skarpaten e brendeshme bimesia eshte me e paket (pasi kanali e D. Martines eshte i veshur me beto) por nga kaperderdhja e ujit jane krijuar grryerje te saj .

Vendi me problematik eshte mbas ures se autostrades ku eshte bere edhe mbrojtja me penela . segment ne te cilin ndodhet edhe ure kanali me gjatesi 127 ml .

Fotografi te argjinatures ekzistuese. Segmenti paralel me urekanalin (mbas permbytjeve te 8 Janarit 2026)





Fotografi te kaperderdhjes se ujit ne argjinatures ne permbytjet e janarit 2026



Fotografi te demtimit te skarpates se brendeshme te argjinatures nga kaperderdhjes se ujit ne permbytjet e janarit 2026



Foto te fillimit te permbytjeve te argjinatures ne Ferras te dates 11 Dhjetor 2021



Foto e nivelit të ujit tek ura e vjetër e Mifolit në permbytjen e datës 11 Dhjetor 2021




• PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I PROJEKTIT

Projekti : Rikonstruksioni i Argjinatura për mbrojtjen nga lumi Vjosa , zona Ferras – ura e Qarrit me gjatësi $L = 1350$ m ka të njëjtin synim si nderhyrjet e deri tani, duke përfshirë argjinaturat (bankinat e kanalit ujor Dega e Martines në progresivin 9958 m deri në progresivin 11308 m) për përballimin e prurjes $Q = 2500 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Vija e projektit të kurores së argjinaturës është hequr duke marrë për bazë të dhënat e nxjerra nga studimi i vitit 2018 , kuotat e përcaktuara në profilin gjatësor të projekt idesë për argjinaturat dhe kryesisht duke marrë në konsideratë dy pikat kryesore ;

Tek ura e Hekurudhës Fier – Vlorë dhe tek ura e autostradës Levan – Vlorë . Edhe në këtë segment shfrytëzohet argjinatura ekzistuese duke bërë mbrojtjen e saj deri në kuotat e kurores të përcaktuara në këtë projekt.

Profili terthor tip i argjinatures qe rikonstruktohet .



Specifikime Teknike

* Punimet ne rikonstruksionin e argjinatures do te fillojne detyrimisht nga pastrimi nga bimesia , prerja e bimeve , shkulja e shkurreve dhe pemeve si dhe sistemimi i tyre .

* Mbas pastrimit nga bimesia do te behet pastrimi nga terreni vegjetal i argjinatures ekzistuese duke bere nje skarifikim ne trashesi prej 20 cm . Ky pastrim do te behet edhe pjesen e terrenit ku parashikohet te shtrihet baza e poshtme e argjinatures per shkak te zgjerimit qe duhet te marri trupi i argjinatur per te arritur kuoten e kurores te kerkuar ne projekt .

* Materialet qe do te nxirren nga prerja e bimesise , shkulja e pemeve dhe terrenit vegjetal me trashesi 20 cm do te depozitohet dhe sistemohet jashte seksionit te argjinatures .

* Mbilartesimi i trupit te argjinatures do te jete i spostuar nga ana e kanalit ujites me 20 cm . Skarpatat e saj nga te dyja anet do te jene 1: 1.5 ashtu si eshte percaktuar edhe ne seksionin terthor .

* Trupi i argjinatures do te realizohet me dhe' te ngjeshur . Dherat per mbushjen e saj do te merren ne karjera sa me pran saj te jete e mundur . Perpara marrjes se dherave do te behet skarifikimi i karjeres . Mbushja dhe ngjeshja me dhe ' e argjinatures do te behet me shtresa jo me te medha se 25 cm . Per cdo shtrese do te realizohet ngjeshja optimale dhe pastaj do te hidhet shtresa tjeter .

. * Meqenese kjo argjinature kalone prane zones se banuar ajo sherbene edhe si rruge per banoret dhe fermeret e zones . Per kete arsye eshte planifikuar qe ne kreun e argjinatures te kemi nje shtrese çakelli mbeturine me trashesi 20 cm e perhapur dhe ngjeshur me makineri .

* Si pike referimi per kuotat do te merret pika me boje te kuqe ne hyrje te ure kanalit (Pik. 17) , ne shpatullen e tij . Kuota e kesaj pike eshte 5,80 m

Ing.H/Teknik Arian SHTEMBARI

Ing.Ndertimi Mimoza DUKA

Ing.Ndertimi Elidon BASHA

Ing.Gjeolog Aleksander RUKAJ

Ing.Topograf Ilsidor PRIFTI

